



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**ADGJA.nr.7/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga I.P., nga fshati Ç..., komuna S..., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, B.D., lidhur me lëndën Cn.nr.1498/18, të Gjykatës së Themelore në Prishtinë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 18.09.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga I.P. nga fshati Ç..., komuna S..., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, B.D., lidhur me lëndën.Cn.nr.1498/18, të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Me datën 12.09.2024 përmes email-it, Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën e I.P. nga fshati Ç..., komuna S.... Në ankesë i njëjti ka theksuar se në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka paraqitur padi me datë 08.05.2018 dhe kjo lëndë evidentohet me numër C.nr.1498/18 dhe se disa herë me parashtrës të ndryshme e kam njoftuar Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me veprimet e gjyqtarit B.D. i cili me qëllim e ka neglizhuar zgjidhjen e çështjes të parashtruar sipas padisë për vërtetimin e pronësisë sipas kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë-konvalidimi i kontratës, pa numër identifikimi, të datës 30.04.2009 dhe vërtetimi i të drejtës pronësore, me propozim për caktimin e masës së përkohshme për sigurimin e kërkesës. Tutje ka theksuar se Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin C.nr.1498/18, të datës 01.10.2021 kishte aprovuar propozimin e paditësit I.P. kishte caktuar masën e sigurimit. I njëjti ka shtuar se përkundër se lënda e tij konsiderohet e natyrës urgjente për faktin se edhe pse është

caktuar masa e sigurisë lidhur me ngastrën kadastrale, një gjë e tillë palët e tjera nuk i ka penguar që të cenojnë paluajtshmërinë në atë mënyrë që i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në atë mënyrë duke i'a pamundësuar edhe gëzimin e së drejtës së pronës, ndërsa lidhur me këtë fakt gjyqtari D. në seancën e fundit që e ka mbajtur për këtë çështje ka qenë ajo e datës 23.09.2021, e që nga ajo kohë i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural edhe përkundër se ka marrë në pyetje dëshmitarët e propozuar si nga ana paditëse por edhe nga ana e palës së paditur duke përfshirë edhe ndërhyrësin ndërsa rezulton se i njëjti ka trajtuar dhe përfunduar lëndë edhe të vitit 2019, 2020, 2021 apo edhe 2022, ndërsa nuk e ka trajtuar lëndën e tij.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 13.09.2024, nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në lëndën Cn.nr.1498/18, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi I.P..

Gjyqtari B.D., ka dhënë deklaratë me datën 13.09.2024, ku ka theksuar se lënda në fjalë në Gjykatën Themelore në Prishtinë është parashtruar me datë 14.05.2018, ndërsa gjyqtari me të njëjtën është ngarkuar me datë 22.01.2019 ndërsa me rastin e avancimit në Gjykatë të Apelit, të njëjtën e ka dorëzuar me datë 30.08.2024. Tutje ka shtuar se lidhur me lëndën në fjalë krahas padisë nga ana e paditësit ka parashtruar edhe propozim për masë të sigurisë, ku lidhur me propozimin për masë të sigurisë janë caktuar dhe mbajtur seanca ku janë dëgjuar edhe palët ndërgjyqëse e dëshmitarë ndërsa sa i përket trajtimit të çështjes kryesore edhe përkundër urgjencave të ushtruara nga pala, ankesave për trajtim të lëndës, në disa prej të cilave me kërkesë të Kryetares së Gjykatës i është përgjigjur, lënda në fjalë nuk është trajtuar jo për ndonjë arsye tjetër, po për shkakun e vetëm se lëndë të natyrës së tillë-pronësore ka pasur në numër të madh më të vjetra se kjo e palës ankuese. Ka shtuar se lidhur me pretendimin e palës ankuese se i njëjti nuk e ka trajtuar lëndën e tij që është e vitit 2018, ku edhe i është referuar numrit të viteve të lëndëve të kryera si ato të vitit 2019, 2020, 2021 apo edhe 2022, thekson se i njëjti është i pabazë, lëndët e kryera e që i përkasin viteve 2019, 2020, 2021 apo 2022, janë lëndë të natyrave tjera familjare, konteste nga marrëdhënia e punës që burojnë nga Kontrata Kolektive, e që shumë prej tyre janë kryer edhe pa shqyrtim kryesor, e të cilave ligji i jep prioritet për trajtim.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit B.D., ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit I.P., është e **pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratës së gjyqtarit, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket zvarritjes së procedurës në mos zgjidhjen e lëndës Cn.nr.1498/18 nga gjyqtari i çështjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i'u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Në Gjykatë lëndët zgjidhen sipas radhës së arritjes së tyre, si dhe llojit dhe natyrës së tyre, për faktin se varësisht prej natyrës së kontestit një lëndë mund të jetë më me prioritet se lënda tjetër. Kryetari i Gjykatës së Apelit, vlerëson se lëndën në fjalë, gjyqtari B.D. e ka pranuar me datën 22.01.2019, ndërsa i njëjti në punë ka pasur edhe lëndë tjera më të vjetra të natyrës pronësore, e të cilat ishin në radhë për t'u zgjidhur, andaj sipas radhës së arritjes gjyqtari i çështjes i ka trajtuar lëndët të cilat i ka pasur në punë.

Gjithashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me datën 08.06.2022, ka miratuar Planin Strategjik për Përmisimin e Qasjes në Drejtësi për vitin 2022-2025, konkretisht për efikasitetin dhe priorizimin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor, si dhe Planin Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për periudhën 2022-2024. Qëllim i planeve të lartcekura është trajtimi i lëndëve brenda afatit të arsyeshëm kohor i përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatuara, si dhe zvogëlimi i lëndëve. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, kryetari i Gjykatës së Apelit vlerësoi se gjyqtari B.D. lëndët të cilat i ka pasur në punë i ka trajtuar konform legjislacioneve në fuqi si dhe planeve strategjike të miratuara nga KGJK.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtari B.D. ka bërë shkelje të Kodit të Etikës.

Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**ADGJA.nr.7/2024, me datë 18.09.2024**

**Kryetari i Gjykatës**

**Valon Totaj**

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarit B.D.
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,